REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**
**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

*Nr. 2083 Prot* *Tiranë më, 12 05.2017*

**Lënda:** Raporti i monitorimit të performancës së produkteve të buxhetit të ILDKPKI, për 4 - mujorin e parë të vitit 2017.

**Drejtuar:** **Znj. Gelardina PRODANI**
**NËPUNËS I PARË AUTORIZUES**
**MINISTRIA E FINANCAVE**

**TIRANË**

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatimin e buxhetit të shtetit për 4-mujorin e parë të vitit 2017, është mbeshtetur në kërkesat institucionale, në zbatim detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, "*Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa nëpunësve Publikë*", i ndryshuar, ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 "*Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike*" i ndryshuar, parandalimit dhe goditjes së korrupsionit në sektorin publik e privat, në përputhje me ligjin nr.60/2016, datë 2.6.2016, "*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*", si më poshtë vijon;

Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në mbështetje të Ligjit nr.130/2016, datë 15.12.2016, "*Për Buxhetin e vitit 2017*", Udhëzimit nr.8, datë 13.1.2017, «*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017*» i ndryshuar, shkresës nr.17911/171 prot, datë 19.1.2017 "*Dërgohet miratimi i detajimit të fondeve për vitet 2017, 2018, 2019*", i është akorduar një fond buxhetor prej 129 milion e 500 mijë lekë, i cili përbëhet nga:
Fondi i Pagave 90 milion (zëri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqërore: 14.5 milion lekë (zëri 601)
Fondi për Shpenzime Operative: 21 milion e 760 mijë lekë (zëri 602)
Fondi për Investime: 3 milion lekë (zëri 231)
Transferime korrente: 240 mijë lekë (zëri 606)

Buxheti është akorduar për programin "*Menaxhim, Administrim, Palanifikim*" dhe është i mbështetur në Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2017-2019.`
Referuar buxhetit të vitit 2017, në respektim të rekomandimeve të dhëna, fondi i planifikuar buxhetor është vënë në funksion të objektivave për forcimin e mëtejshëm të hetimit administrativ, të deklarimit të kontrollit të pasurive dhe për parandalimin dhe zgjidhjen së konfliktit të interesave të personave të zgjedhur, nëpunësve publikë dhe zyrarëve të tjerë. ILDKPKI në mbështetje të burimeve financiare në dispozicion, realizon objektivat e parashikuara, në funksion rritjes së cilësisë së kontrollit të interesave private dhe parandalimit të konfliktit të interesit, qëllimit dhe objektivave të cilat lidhen me zbatimin e politikave

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**
**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

*Tiranë më,___.05.2017*

**Lënda:** Raporti i monitorimit të performancës së produkteve të buxhetit të ILDKPKI, për 4 - mujorin e parë të vitit 2017.

**Drejtuar:** **Znj. Gelardina PRODANI**
**NËPUNËS I PARË AUTORIZUES**
**MINISTRIA E FINANCAVE**

**TIRANË**

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatimin e buxhetit të shtetit për 3-mujorin e parë të vitit 2017, është mbeshtetur në kërkesat institucionale, në zbatim detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, *"Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa nëpunësve Publikë"*, i ndryshuar, ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 *"Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike"* i ndryshuar, parandalimit dhe goditjes së korrupsionit në sektorin publik e privat, në përputhje me ligjin nr.60/2016, datë 2.6.2016, *"Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"*, si më poshtë vijon;

Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në mbështetje të Ligjit nr.130/2016, datë 15.12.2016, *"Për Buxhetin e vitit 2017"*, Udhëzimit nr.8, datë 13.1.2017, *«Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017»* i ndryshuar, shkresës nr.17911/171 prot, datë 19.1.2017 *"Dërgohet miratimi i detajimit të fondeve për vitet 2017, 2018, 2019"*, i është akorduar një fond buxhetor prej 129 milion e 500 mijë lekë, i cili përbëhet nga:
Fondi i Pagave 90 milion (zëri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqërore: 14.5 milion lekë (zëri 601)
Fondi për Shpenzime Operative: 21 milion e 760 mijë lekë (zëri 602)
Fondi për Investime: 3 milion lekë (zëri 231)
Transferime korrente: 240 mijë lekë (zëri 606)

Buxheti është akorduar për programin *"Menaxhim, Administrim, Palanifikim"* dhe është i mbështetur në Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2017-2019.`

Referuar buxhetit të vitit 2017, në respektim të rekomandimeve të dhëna, fondi i planifikuar buxhetor është vënë në funksion të objektivave për forcimin e mëtejshëm të hetimit administrativ, të deklarimit të kontrollit të pasurive dhe për parandalimin dhe zgjidhjen së konfliktit të interesave të personave të zgjedhur, nëpunësve publikë dhe zyrarëve të tjerë. ILDKPKI në mbështetje të burimeve financiare në dispozicion, realizon objektivat e parashikuara, në funksion rritjes së cilësisë së kontrollit të interesave private dhe parandalimit të konfliktit të interesit, qëllimit dhe objektivave të cilat lidhen me zbatimin e politikave

buxhetore, me qëllimin e realizimit të Misionit të ILDKPKI, në përputhje me objektivat prioritare të institucionit.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, në zbatim të Udhëzimit nr.8, datë 13.1.2017, « *Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017* », për periudhën e raportuar, Inspektorati i Lartë, ka realizuar vlerën buxhetore në 36,744,673 lekë ose 76.55%, të fondit të planifikuar për 4-mujorin e parë të vitit 2017.

| Llog. Ek | Peshkrimi | Plan Buxheti vjetor 2017 | Plan Buxheti 4-MUJOR 2017 | Buxheti I realizuar 4 - Mujor 2017 | Realizimi % si 4-Mujor | Buxheti I prokuruar 4-Mujor | Realizim Prok. % si 4-Mujor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 600 | Fond Page | 90,000 | 31,300.0 | 30,033.1 | 95.95% | 30,033.1 | |
| 601 | Kontrib. Sig. Shoq. & Shëndetësore | 14,500 | 4,900.0 | 4,080.0 | 83.27% | 4,080.0 | |
| 602 | Shpenzime operative | 21,760 | 8,720.0 | 2,551.6 | 29.26% | 7,336.0 | 84.1% |
| 606 | Transferime per financime të tjera | 240 | 80.0 | 80.0 | 100.00% | 80.0 | |
| 231 | Investime | 3,000 | 3,000.0 | | 0.00% | 1,510.0 | 50.3% |
| | **Totall** | **129,500** | **48,000.0** | **36,744.7** | **76.55%** | **43,039.1** | **89.66%** |

**<u>Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore</u>**, (zeri 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë 4-mujorit të parë të vitit 2017, numri mesatar i punonjësve është realizuar 69.5 vetë, nga 70 vetë të miratuar.

Fondi i përgjithshem i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë, është realizuar për numrin faktik të punonjësve në vlerën 30,333,096 lekë ose 95.95.26% e fondit të planifikuar për periudhën Janar-Prill 2017 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 4,080,022 lekë ose 83.27%, e planifikimit për periudhën respektive.

Mosrealizimi i fondit të pagave ka ardhur si rezultat i kryerjes së procedurave të rekrutimit, në mbështetje të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, në zbatim të ligjit 152/2013 *"Për nëpunësin Civil"*, i ndryshuar dhe dispozitave ligjore në mbështetje të tij.

**<u>Fondi për shpenzime në zerin investime</u>** *(zeri 231)* ,

Gjithsej fondi i planifikuar i investimeve për vitin 2017, është 3 milion lekë dhe për periudhën respektive, nga fondi i planifikuar, është prokuruar vlera prej 1.51 milion lekë, ose 50.3% e fondit të planifikuar.

Inspektorati i Lartë, në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi dhe të planifikimit në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike të vitit 2017, për këtë zë shpenzimi ka realizuar për këtë periudhë, fondet e planifikuara të vëna në dispozicion si;.

1. Fondi i investimeve me objekt "*Blerje pajisje kompjuterike dhe elektronike*", miratuar si produkt nga Ministria e Financave, është prokuruar për vlerën 1,510,000 lekë me tvsh, me procedurën kërkesë për propozim, fituar nga shoqëria private "BNT ELECTRONICS" Shpk.. Likujdimi do të kryhet në zbatim të kontratës dypalëshe lidhur më datë 28.4.2018.

2. Fondi i investimeve me objekt "*Blerje Pajisje Teknike për Server*", është miratuar si produkt nga Ministria e Financave, në vlerën 1,490,000 lekë me tvsh. Në mbështetje të Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike, kjo vlerë është në proces prokurimi.

**<u>Fondi për shpenzime në zerin Mallra dhe Shërbime</u>** (zeri 602),

Për periudhën respektive, për këtë zë të shpenzimeve, është realizuar gjithsej vlera prej 2,551,555 lekë ose 29.26%, e planifikimit si 4-mujor dhe prokuruar vlera prej 7,335,855.60 lekë ose 84.1% e fondit të planifikuar për këtë periudhë, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi si më poshtë;.

- Sherbimi për '*Ruajtja dhe sigurimi i godinës se ILDKP me roje objekti 24 ore*" është realizuar me procedurën e kërkesës për propozim dhe është fituar nga firma private "International Security Albania" **Shpk,** në vlerën 2,398,108 *(Dy milion e treqind e*

*nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tetë*) lekë me tvsh, ose 79.9% e fondit limit të parashikuar. Likujdimi është kryer çdo muaj në zbatim të kushteve të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, nr.1148 Prot, datë 24.3.2017.

- Fondi i parashikuar për grup artikullin "*Blerje bojë printeri & fotokopje & faksi*" për ILDKPKI, me urdher prokurimi nr.1586 Prot, datë 20.04.2017, me fond limit për 2 milion lekë me tvsh, me proceduren elektronike të kërkeses për propozim., është në vazhdim të procesit të prokurimit elektronik.
- Fondi i parashikuar për grup artikullin "*Mirmbajtje dhe riparime, pjesë këmbimi për 3 automjete*" është prokuruar me procedurën blerje me vlere të vogël dhe është fituar nga firma private "Kombinat Servis" shpk, në vlerën 346,680 lekë me tvsh. Likujdimi do të kryhet në mbështetje të kerkesave te ILDKPKI dhe kushteve te kontrates se lidhur ndermjet paleve, nr.1539 Prot, datë 19.04.2017, në mbështetje të dispozitave në fuqi.
- Gjatë periudhës respektive, shpenzimet në zërin shërbime të ndryshme janë realizuar në përmbushjen e detyrimeve me shtetin si posta, energji, ujë, telefoni. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë lidhur kontrata shpenzim i abonimit ne shtyp, siguracione te detyrueshme per automjetet e ILDKPKI, kontrata e shërbimit të mirëmbajtjes së ashensorit, gjeneratori e tj. të cilat institucioni ynë, i ka likujduar, në mbeshtetje të specifikimeve teknike të sanksionuara në mareveshjet dypalëshe.

Përsa i përket shpenzimeve për blerje mallra të natyrave të ndryshme, institucioni ynë për këtë periudhë, i ka prokuruar dhe realizuar sipas nevojave konkrete, në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi.

**Realizimi i të ardhurave nga veprimtaria e ILDKPKI.**

Të ardhurat nga veprimtaria e ILDKPKI, vijnë kryesisht nga;

1) Arkëtimi i gjobave të vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, nga zyrtarë subjekt të ligjit të deklarimit dhe kontrollikt të pasurive të institucioneve të ndryshme, të cilat për 4-mujorin e parë të vitit 2017, janë 77 raste, në vlerën 14,055,164 lekë.
2) Zyrat Përmbarimore të rretheve për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave, për gjobat e vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore nga zyrtarë subjekt të ligjit. Për 4-mujorin e parë të vitit 2017, janë ekzekutuar tërësisht gjithsej 36 raste, në vlerën 5,900,000 lekë, nga të cilat 18 raste në vlerën 3,100,000 lekë, kanë kaluar në llogari të të ardhurave të ILDKPKI. Arkëtimi në favor të ILDKPKI i 18 rasteve të tjera, të cilat përbëjnë vlerën 2,800,000 lekë, është në proces likujdimi.
3) Të ardhura të tjera të cilat për periudhën respektive, janë në vlerën 34,920 lekë.

**Gjithsej të ardhurat të arkëtuara për 4-mujorin e parë të vitit 2017, janë në vlerën 17,190,084 lekë.**

Të gjitha këto të ardhura, të realizuara në zbatim të ligjeve organike mbi të cilat funksionon Inspektorati i Lartë dhe të VKM nr.432 dt.28.06.2006 "*Mbi të ardhurat në Institucionet Buxhetore*", kalojnë në Buxhetin e Shtetit në masën 100%.

ILDKPKI, për periudhën në vazhdim në mbështetje të kërkesave në rritje, për përmirësim e mëtejshëm të punës në zbatimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara, do të zbatojë me korrektesi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ligji për deklarimin dhe parandalimin e konfliktit të interesave private të zyrtareve, si dhe legjislacionin financiar në fuqi.

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**
**Kozeta NDOI**

# Raportet e Monitorimit

**Buxheti 2017**

## Shtojca Nr.7: Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve Buxhetorë

*ne 000 leke*

| Institucioni | Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit | | | Kodi i Grupit 76 |
|---|---|---|---|---|
| Programi | Planifikim, Menaxhim ,Administrim | Totali I Shpenzimeve | | |
| Artikulli | | Buxheti Perfundimtar | Fakti | Diferenca |
| kodi | Emri | 2017 | 4- M 2017 | 2017 |
| 600 | Paga | 90,000.0 | 30,033.00 | 59,967.00 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 14,500.00 | 4,080.00 | 10,420.00 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 21,760.00 | 2,551.70 | 19,208.30 |
| 603 | Subvencione | | | - |
| 604 | Transferta Korente të Brendshme | | | - |
| 605 | Transferta Korente të Huaja | | | - |
| 606 | Trans per Buxh. Fam. & Individ | 240.00 | 80.00 | 160.00 |
| *Nen-Totali* | *Shpenzime Korrente* | *126,500.00* | *36,744.70* | 89,755.30 |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | | | - |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 3,000.00 | - | 3,000.00 |
| *Nen -Totali* | *Shpenzime Kapitale* | *3,000.00* | *0.00* | 3,000.00 |
| | | | | |
| Totali | Korrente dhe Kapitale | 129,500.00 | 36,744.70 | 92,755.30 |
| *Jashte Buxhetore* | | 0.0 | 0.0 | - |
| Totali (korrente + kapitale + jashte buxhetore) | | 129,500.00 | 36,744.70 | 92,755.30 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Sekretari i Pergjithshem | Emri: | Kozeta NDOI | |
| | Nenshkrimi | | |
| | Data | | 12.5.2017 |

# Raportet e Monitorimit

Buxheti 2017

## Shtojca Nr.8: Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve

*ne 000 leke*

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Institucioni | Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit | | | | | Kodi i Grupit 76 |
| Programi | Planifikim, Menaxhim ,Administrim | | | Totali I Shpenzimeve | | |
| Programi Titulli | Emri | PBA PLAN 2017 | Buxhet Rishikuar 2017 | Buxheti Perfundimtar 2017 | Fakti 4- MUJORI 2017 | Diferenca 2017 |
| 01110 | Planifikim, Menaxhim ,Administrim | 129,500.00 | 129,500.00 | 129,500.00 | 36,744.70 | 92,755.30 |
| | | | | | | |
| Totali | Shpenzime tw miratuara | 129,500.00 | 129,500.00 | 129,500.00 | 36,744.70 | 92,755.30 |

| | | |
|---|---|---|
| Sekretari i Pergjithshem | Emri: | Kozeta NDOI |
| | Nenshkrimi | |
| | Data | 12.5.2017 |

## Raportet e Monitorimit

**Buxheti 2017**

## Shtojca Nr.9 Raporti i Realizimit të Rezultateve të Programit

*ne 000 leke*

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Institucioni | Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit | | | | | | | Kodi i Grupit | 76 |
| Programi | Planifikim, Menaxhim ,Administrim | | | Titulli | 01110 | | | | |
| Kodi | | Njesi | Sasia | Sasia | Realizimi | | | | |
| Rezultatit | Emri I Rezultatit | Matese | e Planifikuar | Prokuruar gjithsej 4-Mujori 2017 | Plotesisht | Pjeserisht | Aspak | Komente | |
| 1 | Blerje Paisje Kompjuterike dhe Elektronike | 000/leke | 1,510,000 | 1,510,000.0 | | X | | Në proces prokur. | |
| 2 | Blerje Pajisje Teknike për Server | 000/leke | 1,490,000 | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | Totali ( kapitale ) | | 3,000,000.0 | 1,510,000.0 | - | | | | |

| | | |
|---|---|---|
| Sekretari i | Emri: | Kozeta NDOI |
| Pergjithshem | Nenshkrimi | |
| | Data: | 12.5.2017 |

## Shtojca Nr.10: Raporti I i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Rezultateve

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Institucioni | Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit | | | | | Kodi i Grupit | 76 | |
| Programi | Planifikim, Menaxhim ,Administrim | | | Titulli | 01110 | | | |
| | | Shpenzimet e Rezultatit | | | | | Kosto per njesi 000/leke | |
| Kodi Rezultatit | Emri I Rezultatit | PBA Plan 2017 | Pl.Buxheti Fillestar 2017 | Pl.Buxheti Perfundimtar 2017 | Fakti 2017 4-M i Pare i prok. | Kosto per njesi Plan 2017 | Kosto per njesi Fakt 2017 | Shpjegime |
| 1 | Blerje Paisje Kompjuterike dhe Elektronike | 1,510 | 1,510 | 1,510 | 1,510 | 68.64 | | Proc. Prok. |
| 2 | Blerje Pajisje Teknike për Server | 1,490 | 1,490 | 1,490 | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | 3,000.0 | 3,000.0 | 3,000.0 | 1,510.00 | | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Sekretari i Pergjithshem | | Emri: | Kozeta NDOI |
| | | Nenshkrimi | |
| | | Data: | 12.5.2017 |

REPUBLIKA E SHQIPERISE INSPEKTORATI I LARTE I DEKLARIMIT TE PASURIVE DHE KONFLIKTIT TE INTERESAVE TIRANE